

 **Force[®] 0.5 G**

Lënda vepruese: Tefluthrin
PËRMBAJTJA: Tefluthrin: 0,5%
Lëndë ndihmëse: 99,5%
Numri i regjistrimit: AL: 2/1-08.10.2010
KS: 017-1130-2009/31.12.2009
Formulimi: Granula

INSEKTICID PIRETROID, NË FORMË MIKROGANULASH, ME SPEKTËR TË GJERË VEPRIMI. PËRDORËT PËR KONTROLLIN AFATGJATË TË DËMTUESVE TË TOKËS. VEPRON NËPËRMJET KONTAKTIT, APARATIT TRETËS DHE AVUJVE. KA VETI REPELENTE.

PËRDORIMI:

KULTURAT BUJQËSORE, DOZAT, MËNYRA DHE KOHA E PËRDORIMIT:

- **Perime**, me dozë 15 – 21 kg/ha. Përdoret në rreshtat dhe në momentin e mbjelljes së farës ose fidanit në vendin e përhershëm.
- **Patate, misër, sojë, lulediell, të lashta** etj. me dozë 12 – 15 kg/ha. Përdoret në rreshtat dhe në momentin e mbjelljes së farës në vendin e përhershëm.
- **Bimët zbukuruese** me dozë 4 – 7 gr/m². Përdoret për trajtime në gjithë sipërfaqen.

DËMTUESIT: Lufton me efektivitet të lartë dëmtuesit e tokës që u përkasin rendeve: Coleoptera, Diptera, Lepidoptera, Miriapodet etj, (*Agriotes spp, Agrotis spp, Chaetocnema spp, Ceuthorynchus spp, Delia spp, Psila spp, Tipula spp, Bibio spp, Melolontha melolontha, Diabrotica spp, Scutigerella spp, Atomaria linearis, Millipedes, Centipedes* etj.).

VËREJTJE: Në kulturat perimore dhe patate, kur infeksionet vazhdojnë, mund të përsëritet trajtimi duke përdorur të njejtën dozë dhe duke e shoqëruar me prashitje, për të mbuluar preparatin në tokë në thellësi 3-5 cm.

TRAJTIMI I FUNDIT PARA VJELJES: Nuk kërkohet, pasi trajtimi bëhet që në mbjellje.

FITOTOKSICITETI: Nuk është fitotoksik kur përdoret sipas rekomandimeve të mësipërme.

Nuk rekomandohet **PËRZIERJA** me PMB të tjera.

PERIUDHA E RUAJTJES: 3 vjet. Preparati ruhet në ambalazhin origjinal, në vende të thata e të ajrosura. Evitoni ruajtjen në temperatura nën 0° C dhe mbi 35° C.


MASAT PARAMBROJTËSE

-Evitoni kontaktin me sytë dhe lëkurën. -Mbroni rrugët e frymëmarrjes duke përdorur mjetet mbrojtëse. -Mos hani dhe mos pini lëngje e duhan gjatë përdorimit. -Gjatë punës përdorni mjetet mbrojtëse. -Mbajeni në vende të sigurta, të ajrosura dhe larg fëmijëve. -Pas përfundimit të punës duart dhe fytyra duhet të lahen dhe rrobat të ndërrohen. -Lani pajisjet mbrojtëse para se ti ripërdorni. -Asgjësoni ambalazhin sipas rregullave në fuqi.

UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

-Në rast kontakti me lëkurën hiqni menjëherë rrobat e ndotura, lani lëkurën me ujë të bollshëm dhe sapun. Lani rrobat e ndotura para se ti rivishni. -Në rast kontakti të preparatit me sytë i lani menjëherë me ujë të bollshëm për 10-15 minuta dhe drejtohuni tek mjeku. -Në rast se merret me organet e frymëmarrjes nxireni të aksidentuarin në vende të ajrosura. -Në rast gëlltitje mos provokoni artificialisht të vjella. Të sëmurin drejtoheni tek mjeku dhe i tregoni atij etiketën. **Trajtimi mjekësor:** Bëni lavazh të stomakut duke patur kujdes të evitoni thithjen e përmbajtjeve të tij. Jepini karbon aktiv dhe purgativ. Antidot nuk njihet. Mjekim simptomatik.

Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.



SHUMË HELMUES PËR ORGANIZMAT UJORE. NUK DEGRADON LEHTËSISHT NË TOKË.

TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.

PRODHUESI: SYNGENTA Limited, Guildford, Surrey GU2 7YH, UK.

Tel: + 44 1438 260 000, Fax: +44 1483 260 001.